

## **Mali I Zi: Diskutohet Bashkepunimi Me Gjykatën Nderkombetare**

**Author:** [Milka Tadic-Mijovic](#)

A do të fillojë me në fund Podgorica të bashkëpunojë me gjykatën për krime lufte?

Arrestimi dhe ekstradimi i të akuzuarve për krime lufte në Malin e Zi duket se do të shnderrohet në një dramë të dhimbshme dhe të gjatë.

Me heret këtu muaj, Haga ka shpallur këtu akuza ndaj figurave ushtarake të implikuara në krime lufte të kryera gjatë sulmit Malazez ndaj Dubrovnikut dhjetë vjet më parë.

Ky hap ka ardhur pasi Podgorica nuk ka arrestuar këtu të akuzuarit, gjeneralin në pension Pavle Strugar, zëvendës admiralin në pension Miodrag Jokiq dhe Milan Zec dhe kapitenin e ushtrisë Jugosllave Vladimir Kovaceviq.

Akuzat ndaj tyre i ishin dorëzuar të mbyllura shefit të policisë Malazeze Vukasin Maras, dhe për këtë ishte njoftuar edhe Presidenti Milo Gjukanović. Por pavarësisht deklaramëve zyrtare të Podgoricës për bashkëpunim me Hagën, asgjë nuk është bërë.

Policia Malazeze ka thënë se Jokiq, Zec dhe Kovaceviq janë larguar të gjithë për në Beograd, por Strugar jeton në Podgoricë dhe zyrtarët lokalë nuk kishin bërë asnjë përpjekje për ta arrestuar që prej sjelljes së mandatit ndaj tij, më 1 Mars.

"Në kemi arritur në përfundimin se nuk po zbatoheshin premtimet e dhëna për bashkëpunim me gjykatën. Autoritetet nuk i kanë arrestuar personat e akuzuar. Kjo ka bërë që ne të shpallim publikisht emrat e personave të akuzuar," ka thënë zedhenesja e gjykatës, Florence Hartman.

Sapo këtu akuza janë bërë publike, Strugar ka njoftuar se ai do të dorëzohet në gjykatën e Hagës me dëshirën e tij. Sipas burimeve të IWPR-se, kjo është vendosur pas bisedimeve me qeverinë Malazeze.

Pas deklaramëve se Strugar, Kryeministri Filip Vujanović ka premtuar publikisht të ndihmojë gjeneralin në cdo mënyrë dhe ka njoftuar gjithashtu se qeveria do të nderhyjë pranë gjykatës ta lërë atë të lirë deri kur të fillojë gjyqi ndaj tij.

Vezhguesit thonë se qeveria ka hezitur për të arrestuar Strugar sepse ai mund të përbejë një dëshmitar shumë të rrezikshëm. Në bashkë me personat e tjerë të akuzuar - të njohur si "të katërtit e Dubrovnikut" - ai ka marrë pjesë në përgatitjet sekrete për "clirimin" e Dubrovnikut, ka dijeni për strukturën e komandimit dhe si pasojë mund të inkriminojë edhe shumë persona të tjerë.

Kjo është vecanerisht e rrezikshme, sepse Haga tashmë ka deklaruar se ka në plan të zgjerojë hetimet për çështjen e Dubrovnikut edhe ndaj disa politikaneve në Podgoricë dhe Beograd.

Meqenese shumë prej atyre që janë sot në pushtet kanë pasur pozicione të larta drejtuese edhe gjatë periudhës së fushatës ndaj Dubrovnikut, autoritetet do të jenë edhe me pak të interesuara për të bashkëpunuar në fazën e dytë të hetimeve.

Megjithate, ndersa Mali i Zi ka disa kohe qe ka humbur perkrahjen qe gezonte ne Perendim, duket se nje fare ndihme do te jepet, meqenese qeveria nuk deshiron te perkeqesoje edhe me teper pozitat e saj.

Me 9 Tetor, haga ka njoftuar se edhe 15 persona te tjere do te vendosen nen hetim per krime te kryera ne Kroaci. Ketu perfshihen dy ish zyrtare te larte Malazez: momir Bulatoviq dhe Branko Kostiq.

Ne Podgorice jane shtuar fjalet rreth personave te cilet do te perfshihen ne ndonje liste te ardheshme te gjykates - dhe mbi te gjitha, nese Haga do te therrase edhe Presidentin Millo Gjukanoviq.

Ne kohen e sulmit ndaj Dubrovnikut ne vjeshten e vitit 1991, Gjukanoviq ka qene kryeminister i Malit te Zi, dhe nje aleat i ngushte i Slllobodan Millosheviqit. Gjashte vjet me pas, Gjukanoviq u shkeput nga Millosheviqi, filloi te perdore nje gjuhe paqesore dhe u perpoq te krijonte ura me shtetet e tjera Ballkanike.

Ne vitin 1999, ai i ka kerkuar zyrtarisht falje Kroacise per sjelljen e ushtareve dhe forcave jo te rregullta Malazeze gjate sulmeve ndaj Dubrovnikut. Gjate fushates ne Kosove ne vitin 1999, zyrtaret Malazez kane shkuar ne Hage per te kerkuar akuzimin e atyre qe kane kryer krime, por ata jane treguar shume me pak aktiv ne nxjerrjen e krimineleve te luftes Malazez perpara drejtesise.

Strugar nuk eshte i vetmi qe ka levizur i pashqetesuar ne Mal te Zi. Millosheviq dhe presidenti Serb Milan Milutinoviq dihet se kane vizituar Malin e Zi disa here pas ngritjes se akuzave zyrtare ndaj tyre.

Edhe i akuzuari nga Haga Gjenerali Ratko Mladiq ka shijuar bregdetin e bukur Malaze pa terhequr vemendjen e policise. Tani, ministri i ri i policise Andrija Joviceviq insiston se te gjitha te akuzuarit qe gjenden ne territorin Malazez do te ekstradohen menjehere. Nese kjo deklarate perben nje deshire te re per bashkepunim me gjykaten apo me teper nje retorike boshe, kjo mbetet per t'u pare.

Milka Tadiq Mijoviq eshte redaktore e projektit te IWPR-se, dhe redaktore e revistes se perjaveshme monitor, qe botohet ne Podgorice.

**Location:** [Kosovo](#)  
[Croatia](#)

---

**Source URL:** <https://iwpr.net/sq/global-voices/mali-i-zi-diskutohet-bashkepunimi-me-gjykaten>